



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

Nr. 2345/Prot.

Pogradec, më 26.06.2025

VENDIM

NR. 53, DATË 25.06.2025

MIRATIMI I PROCESVERBALIT TË MBLEDHJES SË DATËS 29.05.2025 TË
KËSHILLIT BASHKIAK POGRADEC

Këshilli I Bashkisë Pogradec në mbledhjen e tij të datës së sotme, pasi lexoi proces-verbalin e zbardhur nga Sekretarja e Këshillit të mbledhjes së datës 29.05.2025, në mbështetje të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" neni 53, pika 8 dhe neni 54, gërma k si dhe neni 92 e Rregullores së Funksionimit të Këshillit të Bashkisë Pogradec miratuar me VKB nr 40, datë 05.03.2020.

KËSHILLI I BASHKIAK

VENDOSI:

1. Të miratojë proces verbalin e mbledhjes të Këshillit të Bashkisë Pogradec , të datës 29.05.2025 bashkangjitur.
2. Kopja e proces verbalit të miratuar administrohet nga Sekretarja e Këshillit sipas procedurave ligjore.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE E KËSHILLIT

Manjola KAMOLLI

1.Miratuar me 20 vota

2.Vota Pro 20

3.Vota Kundër 0

4.Vota Abstenim 0

5.Zbardhur më date 26.06.2025



ORA : 12:00

JANË PREZENT 23 KËSHILLTARË PROTOKOLLI I MBLEDHJES SË KËSHILLIT BASHKIAK POGRADEC DATE 29.05.2025, ME KËTË REND DITE.

1. Projekt – Vendim: Miratimi i Rendit të ditës.
2. Deklarimi I konfliktit të interesit nga këshilltarët, për vendimarrjen lidhur me cështjet e rendit të ditës.
3. Projekt – Vendim : Miratimi i Procesverbalit të datës 16.05.2025.
4. Leximi I vendimeve dhe konfirmimet e prefektit për mbledhjen e datës 16.05.2025.
5. Projekt – Vendim : Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi 6% e fondit të kushtëzuar për bllok – ndihmën ekonomike, për muajin Prill 2024.
6. Projekt – Vendim "Miratimin e kryerjes së shërbimit me objekt: "Pastrimi, grumbullimi dhe largimi i mbeturinave të qytetit të Pogradecit dhe Njësive administrative"
7. Projekt – Vendim : Miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2026-2028 të Bashkisë Pogradec (faza1)
8. Projekt – Vendim : Për miratimin e bonusit të qerasë për znj.Teuta Cela në Bashkinë Pogradec.
9. Projekt – Vendim: Për miratimin në parim të dhënies me qira, në favor të individëve kërkues për shesh për depozitimin e përkohshëm të materialeve të ndryshme (pika transporti), të pasurisë me sipërfaqe totale 40000 m² (dyzet mijë) m²
10. Raportim në Këshillin e Bashkisë për punën e Drejtorisë së Turizmit, Trashëgimisë Kulturore dhe Rinisë dhe përgatitjet për sezonin veror 2025 .
11. Ankesa, Kërkesa
12. Të tjera .

1. Projekt – vendim : "Miratimi I Rendit të ditës".

Diskutime

M.Kamolli: Pershendetje te gjithve ! Fillojme mbledhjen e sotme te keshillit bashkiak dt. 29.5.2025. Jane present 23 keshilltare. Ne mbledhjen e komiaioneve jane propozuar dy project-vendime shtese.

1. Per krijimin e keshillit artistiko-kulturor dhe shperblimin e antarve te tij.

2. Per dhenie ndihme financiare per z.Mondi Muca.

Po lexoj rendin e dites duke perfshire edhe 2 projekt-vendimet shtese dhe ju lutem ta hedhim ne votim.

U votua

Pro 23

Kundër 0

Abstenim 0

Miratohet Po Jo

2. Deklarimi I konfliktit të interesit nga këshilltarët, për vendimarrjen lidhur me çështjet e rendit të ditës

M.Kamolli :Ju lutem keshilltarve nese dikush ka konflikt interesi me donje nga pikat e rendit te dites te deklarohet.

Une deklarohem per konflikt interesi me piken nr.1 shtese te rendit te dites dhe doriqem nga votimi .

Mbledhje e Këshillit Bashkiak

Pogradec më 29.5.2025

3. Pika nr ____ : "Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së datës 16.5.2025 të Këshillit Bashkiak Pogradec".

M.Kamolli: Pika nr.2. është miratimi i proces-verbalit të mbledhjes dt.16.05.2025.

Ju lutem ta hedhim në votim, pikën nr 2 të rendit të ditës.

ora 12:07 vjen znj.A.Prifti

U votua

Pro 24

Kundër 0

Abstenim 0

Miratohet Po Jo

Mbledhje e Këshil Bashkiak

Pogradec më 29.05. 2025.

4. Pika nr. 4: "Leximi i vendimeve dhe konfirmimi i prefectures per mbledhjen e dates 16.5.2025".

Diskutime

M. Kamolli :Ne kete mbledhje nuk kemi konfirmim per te lexuar ,per shkak se nuk kemi derguar vendime per konfirmim ne prefecture.

5. Projekt-vendim: Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi 6% e fondit të kushtëzuar për bllok – ndihmën ekonomike, për muajin Prill 2025.

Diskutime

M.Kamolli: Vazhdojmë me projekt-vendimin e 6%. Ky është projekt-vendim që ne e miratojmë çdo muaj.

Degjojme specialisten

L.Mancellari:

Për muajin prill 2025 do të trajtohen me ndihmë ekonomike nga fondi 6% i fondit të kushtëzuar të ndihmës ekonomike për muajin PRILL 2025 gjithsej 177 familje me fond 730111 leke.

Procedura është e njëje. E vetmja gjë që ndryshon është nr. i familjeve të cilat trajtohen me ndihmë ekonomike nga fondi 6%.

M.Kamolli: E hedhim në votim pikën nr.5 të rendit të ditës.

U votua

Pro 24

Kundër 0

Abstenim 0

Miratohet Po Jo



6. Projekt – Vendim: Miratimin e kryerjes së shërbimit me objekt: "Pastrimi, grumbullimi dhe largimi i mbeturinave të qytetit të Pogradecit dhe Njësive administrative".

M.Kamolli: Vazhdojme me piken nr.6 te rendit te dites. Ky project-vendim u diskutua ne mbledhjen jashte radhe por per shkak te mosplotesimit te korumit nuk arriti ye hidhet ne votim. Gjithsesi nese dikush nga ju do te kete ndonje pyetje grupi I punes eshte ketu dhe mund t'ju pergjigjet.

K.Bisgjoni; nje lapsus qe ishte bere ne project-vendim e kemi rregulluar, tjeter ndryshim nuk ka.

K.Beka: Per mua duhet te sarohej qe fondi limit eshte me I ulet se ai I heres se kaluar, por jo aq I ulet sac mendoj se duhet. dhe gjeja tjeter qe duhet te diskutohet eshte fakti qe duhet te monitorohet pastrimi I qytetit per mirfunksionimin e tij.

K.Bizgjoni ;Fondi limit eshte me I ulet per shkak te rritjes se nivelit te pages baze dhe uljes se cmimit te naftes.

Shërbimi i pastrimit dhe grumbullimit të mbetjeve urbane është një shërbim thelbësor për

mirëmbajtjen e higjienës publike dhe mjedisit, si në qytet ashtu edhe në njësitet administrative.

Ky shërbim përfshin mbledhjen, transportimin dhe largimin e mbetjeve të ndryshme nga zona

urbane dhe rurale, duke kontribuar në mbrojtjen e shëndetit të popullsisë dhe ruajtjen e mjedisit.

Bazuar në numrin e popullsisë, numrin e turistëve përgjatë sezonit turistik, sasia e mbetjeve të

prodhuara ka pasur tendencë në rritje gjithashtu, duke bërë të domosdoshëm një planifikim të

mirëfilltë dhe një implementim efikas të shërbimeve të pastrimit.

M.Kamolli :Atehere koleg e hedhim ne votim piken nr.6 te rendit te dites.
Ora 12:11 Vjen A.Male

U votua

Pro 23

Kundër 1 Klajdi

Abstenim 1.Ervini

Miratohet **Po** **Jo**

7. Projekt – Vendim: “Miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2026-2028 të Bashkisë Pogradec (faza1)

Diskutime

M.Kamolli:Vazhdojme me miratimin e PBA-se,faza e pare.

Jerina:

Faza e pare e procesit e PBA-se,zhvillohet ne perjudhen janar-qershor.Dokumentacioni perkates I fazes se pare te PBA-se eshte pergatitur sipas formateve standarte te sistenit te menaxhimit te buxhetit vendor dhe do te dergohet tek Ministria Finances deri ne daten 1 korrik sipas afateve ligjore.

Gjate kesaj faze jane hartuar deklaratat e politikave te programit DPP dhe planet e shpenzimevete programeve si per politikat ekzistuese dhe ato te reja ne perputhje me tavanet orjentuese te percaktuara per cdo program.

C.Haxhillari:PBA-ja eshte procedure e zakonshme qe behet vite pas viti.Ajo qe bie ne sy eshte fakti qe eshte mare parasysh niveli I pagve dhe nr.i popullsise si dhe nje plan I pergjithshem investimesh qe me tepere shkon per mirmbajtje.

M.Kamolli :nese jeni dakort ju lutem e hedhim ne votim piken nr.7 te rendit te dites

U votua

Pro 25

Kundër 0

Abstenim 0

Miratohet Po Jo



Mbledhje e Këshillit Bashkiak

Pogradec më 29.05 2025

8. Projekt – Vendim:

: Për miratimin e bonusit të qerasë për znj.Teuta Cela në Bashkinë Pogradec.

Diskutime

M.Kamolli :Vazhdojme me dhenien e bonusit te qeras per znj.Teuta Cela.

Besa:

Aplikuesja është nënë e divorcuar me tre fëmije. Trajtohet me ndihmë ekonomike dhe është anëtare e kominitetit egjiptian.

Në bazë të kushteve të vështira ekonomike ,sociale dhe jetesës, zyra e strehimit kërkon shtyrjen e afatit të subvencionimit të bonusit të qerasë edhe për 12 muaj, pasi qytetarit në fjalë akoma nuk i është gjetur një strehim përfundimtar.

M.Kamolli : Ju ftoj koleg ta hedhim ne votim piken nr.8 te rendit tet dites

U votua

Pro 25

Kundër 0

Abstenim 0

Miratohet Po Jo

Mbledhje e Këshillit Bashkiak

Pogradec më 29.05.2025

9.Projekt – Vendim: Për miratimin në parim të dhënies me qira, në favor të individëve kërkuar për shesh për depozitimin e përkohshëm të materialeve të ndryshme (pika transporti), të pasurisë me sipërfaqe totale 40000 m² (dyzet mijë) m²

M.Kamolli :Vazhdojmë me piken nr.9 te rendit te dites.

K.Topa:Ky project vendim ka kaluar nga keshilli ne konsultim public.Konsultimi eshte realizuar.Une kam qene e pranishme dhe banoret kne qeneunanimisht dakort.

Madje ata shpreheshin se ky project-vendim u vinte atyre ne ndihme per dy arsye;

1.Per faktin qe makinat e tonazhit te rende nuk do kalojne me ne fshat dhe do te evidentohet ndotja.

2.Investime te tilla hapin vende te reja pune per banoret.

E.Mancellari: une u jam mirnjohes keshilltarve qe kane shkuar ne konsultim ,por do doja qe project-vendimi te shtyhej per heren tjeter ,sepse dua qe te jene te pranishem ketu kryeplaku dhe administrator per arsyen e thjeshte se ata I dine me se miri problemet e sones .

Klea: Ne konsultim kane qene banoret dhe kryeplaku I fshatit dhe nuk ka asnje problem.

M.Kamolli:Konsultimi prandaj kryet dhe perderisa nuk ka asnje kundershtrim uk kemi pse ta shtyjme miratimin e projek-vendimit.

Haxhillari:Toka eshte e bashkise dhe do te jepet ,por qellimi I konsultimit eshte evidentimi I kerkese-ankesave te banorve.

Perderisa nuk ka pasur kundershtime nuk kemi pse ta shtyjme .

m.kamolli : atehere e hedhim ne votim.

Largohet B.Xhyra

Pro ___21_____

Kundër ___0_____

Abstënim ___3A.Prifti,A.Male,E.Mancellari

Miratohet Po Jo



Mbledhje e Këshillit Bashkiak

Pogradec më 29.05 2025

10.Projekt – Vendim: Për krijimin e keshillit artistiko-kulturor dhe shperblimin e antarve te tij.

M.Kamolli:Vazhdojme me krijimin e keshillit artistiko-kulturor dhe shperblimin e antarve te tij.

Besi;

Referuar organogramës rezulton se struktura e shoqërisë, ndër të tjera përbëhej nga tre drejtori:

Drejtoria e administrates dhe sherbimeve mbeshtetese dhe dy drejtori kryesore, Drejtoria e Sporteve dhe Drejtoria e Kulturës – Qendra Kulturore, "Lasgush Poradeci".

Në kuadër të veprimtarisë sportive, Shoqeria Qendra Multifunksionale Pogradec Sha, ka krijuar

dy ekipe sportive profesionistë, Ekipin e Vajzave në Volejboll të cilat marrin pjesë në Superligë

të Kampionatit të Volejbollit dhe Ekipin e Meshkujve Basketboll të cilët marrin pjesë në Kategorinë e Parë të Kampionatit Shqiptar të Basketbollit.

Gjithashtu, ekziston edhe Akademia e Sporteve Pogradeci, ka stërviten rreth 200 sportistë të rinj,

nga mosha 9 – 18 në disiplinat sportive Volejboll, Basketboll, Kung – Fu, Not, etj.

Qendra Multifunksionale Pogradec Sha, është e njohur dhe anëtare me të drejta të plota nga

Federatat Shqiptare të Sporteve si më poshtë:

Këshilli Artistiko-Kulturor, do të shërbejë si forum vlerësues i cilësisë artistike, këshillues dhe koordinues për nxitjen dhe promovimin e veprimtarive në këto fusha, duke detajuar qëllimet si

më poshtë:

- Promovimi i artit, kulturës dhe sportit në nivel lokal.
- Kordinimi i aktiviteteve gjatë gjithë vitit, duke përfshirë festivale, ekspozita, ngjarje sportive etj.
- Konsultimi dhe sugjerimi për politikat e zhvillimit kulturor në Bashkinë Pogradec.
- Identifikimi dhe mbështetja e personaliteteve dhe grupeve artistike dhe sportive.
- Ruajtja dhe promovimi i trashëgimisë kulturore dhe artistike të qytetit.

Këshilli do të përbëhet nga personalitete të shquara në fushat e artit, kulturës dhe sportit në

Bashkia Pogradec, të propozuara nga institucionet përkatëse dhe komuniteti lokale, dhe do të

mbështetet nga zyrtarë të Bashkisë dhe të Qendrës Multifunksionale Pogradec Sha.

Struktura e Këshillit Artistiko – Kulturor, propozohet të jetë:

1. Kudret DUROLLARI KRYETAR PIKTOR
2. Edmond GUSHO ANËTAR KOMPOZITOR
3. Ilir SHYTA ANËTAR PEDAGOG LETARR

Përfitimet e krijimit të Këshillit:

- Nxitje e zhvillimit të plotë të mundësive artistike, kulturore dhe sportive.
- Forcimi i identitetit kulturor lokal dhe ndërkombëtar.
- Rritja e turizmit përmes aktiviteteve kulturore.
- Përmirësimi i bashkëpunimit ndërinstitucional në fushën e arteve dhe sportit.

Krijimi i Këshillit Artistiko-Kulturor në Bashkinë Pogradec, i cili do jetë organ këshillues dhe vendimarrës pranë Qendra Multifunksionale Pogradec Sha, është një hap i rëndësishëm drejt

promovimit të vlerave kulturore, artit dhe sportit në qytet, ndërsa do të kontribuojë në zhvillimin

ekonomik dhe social të komunitetit dhe ruajtjen e trashëgimisë së pasur kulturore të qytetit.

M.Kamolli teriqet nga votimi per shkak te konfliktit te interest me project-vendimin ne fjale.

M.KAMOLLI :ju lutem ta hedhim ne votim piken nr 1 shtese te rendit te dites

Pro ____24____

Kundër ____0____

Abstenim ____0____

Miratohet Po Jo

11. Projekt – Vendim: Për dhenie ndihme financiare z.Moni Muca

M.Kamolli :Vazhdojme me dhenien e dihmes financiare per z.Mondi Mua.

kerkesen e tij e kemi lexuar ne keshill dhe e kemi percjelle te financa.

Ju lutem e hedhim ne votim

Pro _____25_____

Kundër _____0_____

Abstenim _____0_____

Miratohet Po Jo



Mbledhje e Këshillit Bashkiak

Pogradec më 29.05. 2025

12. Raportim në Këshillin e Bashkisë për punën e Drejtorisë së Turizmit, Trashëgimisë Kulturore dhe Rinisë dhe përgatitjet për sezonin veror 2025 .

Drejtori i Drejtorisë së Turizmit ka përgatitur një material ku paraqet të gjitha



Mbledhje e Këshillit Bashkiak

Pogradec më 20.05. 2025

13 Ankesa-Kerkesa

J.Bojko lexon kerkesen e subjektit "Sarolli SH.P.K" I cili kerkon rishikim taksash.

Kerkesa do te percillet me shkrese perciellse tek drejtoris perkatese.

M.Kamolli :Mbledhjen e deklaroj te mbyllurr.

Protokolloi: Matilda Tollaku